



REPUBLICA E KOSOVËS / DRŽAVNA TUŽILAC / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E BUDIVËSISË PËR TARRË DHE ZHVLIMTARIN / MINISTARSTVO POKLONIVARJE, SAGREDE
I RURALNOG RAZVITJA / MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS / AGENCIJA ZA ŠUMI KOSOVA / KOSOVO FOREST AGENCY
DIREKTORIA E INSPEKTORATIT TË PYLLTARISË DHE GJITHSË DREKTORIA ZA INSPEKCIJU
ZA ŠUMARSTVO I LUVSTVU / DIRECTORATE FOR INSPECTION OF FORESTRY AND HUNTING

Nr. i Prot. 156/21
Prat. Nr. 07.06.2021
05



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Ferizaj / Osnovno Tužilaštvo Ferizaj / Ferizaj Basic Prosecution
Departamenti për Krime të Rënda / Odeljenje za Teške Zlocine / Serious Crimes Department

PP.I.nr.54/21

Data:01.06.2021

NJOFTIM

Për:

AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS

z.BESIM ZOGU, adresa:Lagja e Spitalit, rruga "Ernest Koliqi", 10000 Prishtinë

Ju njoftojmë se Prokurori i Shtetit në bazë të nenit 82 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPP-së, me aktvendim ka **HUDHË** kallëzimin penal ndaj të dyshuarit [REDACTED] për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK-së, ngase nuk është vërtetuar se në veprimet e të njëjtit përmbushen elementet e veprës së pretenduar penale apo të donjë vepre tjetër e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Për hedhjen e kallëzimit penal njoftoheni në pajtim me nenin 82 paragrafi 3 të KPP-së.

Shtojcë: Aktvendim për hudhje.

PROKURORI I SHETIT

Sebanate SINANI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Ferizaj / Osnovno Tužilaštvo Ferizaj / Ferizaj Basic Prosecution
Departamenti për Krime të Rënda / Odeljenje za Teške Zlocine / Serious Crimes Department



Numri i lëndës: 2021:0018690

Datë: 01.06.2021

Numri i dokumentit: 01367273

PP.I.nr.54/21

PROKURORIA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti për Krime të Rënda: Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani, në çështjen penale kundër të dyshuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, me datë 02.06.2021 merr:

AKTVENDIM

HUDHET kallëzimi penal i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Agjencia Pyjore e Kosovës kundër të dyshuarit [REDACTED] për shkak të dyshimit për kryerjen e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 i KPRK-së, sepse

-Në bazë të nenit 82 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të KPP-së, nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Ferizaj me datë 16.03.2021, ka pranuar kallëzimin penal me numër DQIPGJ-67/21 të parashtruar nga Agjencia Pyjore e Kosovës kundër te pandehurit [REDACTED] në drejtim të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 i KPRK-së.

Në bazë të këtij kallëzimit penal rezulton se gjatë vitit 2020, në terrenin Pleshina 1, i dyshuari në cilësinë e personit zyrtar si roje pylli, me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për vete, ka shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare, duke i tejkaluar



Numri i lëndës: 2021:0018690

Datë: 01.06.2021

Numri i dokumentit: 01367273

kompetencat e tij si dhe me dashje nuk i ka kryer detyrat e tij të domosdoshme të përcaktuara me ligjin 03-L-029 për Inspeksionin bujqësorë dhe Udhëzimin administrativ për Mbrojtjen e pyjeve, përgjegjësitë dhe obligimet e rojës së pyllit, në atë mënyrë që ka bërë tejkalimin e sasisë së dëmit të shkaktuar në pyje dhe të pa mbuluara me fletëparaqitje në sasi prej 305.84 metër kub, me ç'rast Agjencionit Pyjor të Kosovës i ka shkaktuar dëm material në vlerë të përgjithshme prej 41.853.33 €.

Në mënyrë që të sigurohen prova shtesë lidhur me këtë çështje penale, Prokurori i Shtetit ka autorizuar hetuesit policor nga Drejtoria e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Ferizaj që të ndërmarrin edhe disa veprime hetimore në drejtim të grumbullimit të provave dhe ndriçimit të kësaj çështje penale, ndërsa pas përfundimit të veprimeve hetimore të autorizuara, hetuesit policor me datë 28.05.2021 në këtë prokurori kanë dorëzuar Raportin informues me të gjitha provat e siguruar, si dhe në bazë të autorizimit të Prokurorit të Shtetit, janë intervistuar [redacted] në cilësinë e të dyshuarit dhe Mehdi Berisha në cilësinë e përfaqësuesit të dëmtuarës.

Nga deklarata e Mehdi Berishës, në cilësinë e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të dhënë pranë Drejtorisë së Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Ferizaj, rezulton se me datë 16.03.2021 kanë dorëzuar një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, kundër [redacted] rojë pylli në Autoritetin Pyjor Komunal në Ferizaj, i cili kallëzim penal është paraqitur në bazë të raportit të pranuar nga Komisioni i përbërë nga Lumni Salihukryetar, Beqë Uka dhe Hetem Makolli anëtarë, raporti mbi kontrollin-regjistrimin e dëmit të rajonit ekonomik Pleshina 1, ku rojë pylli ka qenë pikërisht [redacted] dhe në bazë të këtij raporti është cekur dëmi i paarsyetuar prej 305.84 metër kub. Po ashtu deklaron se nuk është në dijeni se roja e pyllit [redacted] ta ketë njoftuar dikë në pylltari që në këtë terren ka qenë duke u dëmtuar pylli.

Nga deklarata e dëshmitarit Lumni Salihu të dhënë pranë Drejtorisë së Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Ferizaj, rezulton se bazuar në të gjeturat e komisionit kanë paraqitur kallëzim penal nga rojës së pyllit [redacted] meqë në rajonin ku i njëjti ka qenë i angazhuar të punoj është shkaktuar dëm në sasi prej 305.84 metër kub dru të cilat i njëjti nuk ka arritur ti arsyetoj me fletëparaqitje. Sipas tij, roja e pyllit [redacted] ka qenë prezent gjatë gjithë kohës sa komisioni ka bërë revizionin-regjistrimin në rajonin Pleshina-1, mirëpo i njëjti nuk ka nënshkruar raportin edhe pse të njëjtit ia kishte prezantuar këtë raport. Më tej deklaron se nuk ka qenë i njoftuar nga roja e pyllit [redacted] se është duke u dëmtuar pylli në masë të konsiderueshme dhe po ashtu nuk është në dijeni se i njëjti a e ka njoftuar dikë, kjo për faktin se ai ka qenë në mbikëqyrje të teknikut Muja Shabani.


Shton se si përgjegjës, në mbështetje të udhëzimit administrativ për mbrojtje të pyjeve dhe përgjegjësit, obligimet e rojës së pyllit 05/2010, neni 24, ndaj rojës [redacted] ka iniciuar procedurë disiplinore për shkak të mungesës së asaj sasive drunore.



Numri i lëndës: 2021:0018690
Datë: 01.06.2021
Numri i dokumentit: 01367273

I dyshuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij të paraqitur pranë Drejtorisë së Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Ferizaj e me autorizimi të Prokurorit të shtetit, ka deklaruar që nga viti 2019 është i punësuar si rojë pylli me kontratë mbi vepër, ka për obligim ta ruaj rajonin "Pleshina 1" dhe se detyrat e tij si rojë pylli janë që ta ruaj pyllin nga dëmtuesit e ndryshëm, nëse has në ndonjë zjarr në rajonin ku kujdeset dhe nëse nuk mund ta shuaj vetë, t'i njoftoj zjarrfikësit. Sa i përket rastit konkret deklaroi se gjatë regjistrimit të rregullt vjetor që është bërë nga komisioni i përbërë nga Lumni Salihu-kryetar, Beqë Uka dhe Hetem Makolli anëtarë, ka qenë prezent gjatë gjithë kohës dhe se raportin e këtij komisioni nuk e kishte nënshkruar për faktin se revizioni-regjistrimi sipas tij nuk bëhet njëjtë për të gjithë rojet e pyllit, ngase në rajonin i cili kufizohet me rajonin e tij shihet qartë se është dëmtuar në masë shumë më të madhe, mirëpo në regjistrim është shumë më mirë se në rajonin ku është i caktuar që ta ruaj. Po ashtu deklaroi se punon me 8 orë pune në ditë, pra duke filluar nga ora 08:00 deri në ora 16:00, ndërsa 2 ditë pushim në javë, përkatësisht të shtunën dhe të dielën pushim, ndërsa nuk zëvendësohet gjatë kohës sa nuk është në punë nga ndonjë rojë pylli tjetër, hapësira –terreni që ka për detyrë ta ruaj është jashtëzakonisht e madhe, prej 1,000 hektar, prandaj edhe e ka të pamundur që ta kontrolloj gjithë ai rajon si roje e vetme për at terren.

Prokurori i Shtetit pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha provat që janë pjesë e shkresave të lëndës dhe pas krahasimit të tyre një nga një, nuk ka arritur të vërtetoj se në veprimet e të pandehurit [REDACTED] përmbushen elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së, kjo për faktin se bazuar në këtë dispozitë ligjore, këtë vepër penale e kryen "personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij, me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo që t'i shkaktoj dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër", e që në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dyshuari me veprimet e tij i ka tejkaluar kompetencat ose nuk i kanë përmbushur detyrat e tij zyrtare apo të ketë përfituar ndonjë dobi pasurore për vete ose për tjetrin, ndërsa sa i përket dëmit të shkaktuar Agjencisë Pyjore të Kosovës, kjo ka mund të vij si pasojë e angazhimit të një roje të vetme në atë terren apo hapësirë të gjerë dhe mos zëvendësimit të rojës së pyllit nga ndonjë roje tjetër përderisa i njëjti nuk ka qenë në detyrë, për faktin se rojet e pyllit me kontratë janë të obliguar që të punojnë 8 orë në ditë dhe gjatë javës kanë të drejtë në 2 ditë pushimi si dhe terreni që të njëjtit kanë obligim që ta ruajnë, pas orarit prej 8 orëve dhe gjatë ditëve të pushimit nuk mbulohet nga askush, prandaj edhe ky dëm shumë lehtë ka mundur që të shkaktohet gjatë kësaj kohe.



Numri i lëndës: 2021:0018690
Datë: 01.06.2021
Numri i dokumentit: 01367273

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, Prokurori i Shtetit, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk ka asnjë provë që do të vërtetonte dyshim të arsyeshëm ose të bazuar se është kryer vepra penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK-së, nga ana e të dyshuarit [REDACTED] për sa i takon mos kryerjes së punës në mënyrën e duhur nga ana e rojës së pyllit [REDACTED] pra mungesës së sasisë drusore, punëdhënsi ndaj të njëjtit mund të ndjekë procedurat disiplinore dhe administrative.

Andaj, në mungesë të elementeve të veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK-së, si dhe në mungesë të elementeve të veprave tjera penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare **HUDHET** kallëzimi penal.

PROKURORI I SHËTETIT
Sebahate SINANI

